



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 24, dt. 10.06.2024

MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR BASHKINË KORÇË, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË REZIDENCËS ARTISTIKE NË KORÇË, SI DHE NDRYSHIMIT NË BUXHET

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 14 dhe neni 77, Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimin nr.9 dt.20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin plotësues nr.1 dt.24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.25 dt.22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024, ”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

V E N D O S I

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Bashkinë Korçë për Projektin e ndërtimit të Rezidencës Artistike në Korçë
2. Të miratojë financimin e kontributit të Këshillit të Qarkut në këtë Projekt në vlerë 3 milion lekë sipas preventivit bashkëngjitur.
3. Të miratojë ndryshimin në buxhet si më poshtë për plotësimin e vlerës të kërkuar të projektit
*Pakësohet
-03/10430/01/602 800'000 lekë (Karta e studentit)
*Shërohet
-03/04130/01/604 800'000 lekë(Projekti i Rezidencës Artistike ne Korçë)
4. Pjesa e mbetur prej 2.2 milion lekë do të financohet nga plani i shpenzimeve operative të përcaktuara për këtë qëllim me urdhërin nr.69 dt.03.06.2024

5. Totali i fondit prej 3 milion lekësh do të kalojë në llogarinë e Bashkisë Korçë në thesar, në formën e kontributit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve burimeve njerëzore dhe zhvillimit të teritorit

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi

Miratuar me / 15 / Vota
Vota Pro / 15 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /10/ 06/2024



Konceptoi: *O. Beqiraj*
Konfirmoi: Keshill Juridike: *M. Bylykbaski*
Pranoi: *Sek. K. Q. B. Muço*



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR BASHKINË KORÇË, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË REZIDENCËS ARTISTIKE NË KORÇË, SI DHE NDRYSHIMIT NË BUXHET

Bashkia Korçë me kërkesën e saj datë 31.05.2024 në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe pozitiv ndërinstitucional midis dy Institucioneve tona, i është drejtuar Këshillit të Qarkut për mbështetje financiare për projektin e ndërtimit të Rezidencës Artistike në Korçë.

Rezidenca do të shërbejë si një vend dhe hapësirë e domosdoshme për shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave midis artistëve dhe profesionistëve të kulturës. Ky projekt synon që të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e projekteve artistike. Shuma prej 3 milion lekësh e kërkuar nga Qarku Korçë do të shërbejë për mbulimin e shpenzimeve vjetore të qerasë dhe shpenzimeve operative të qëndrës.

Duke vlerësuar impaktin që mund të ketë ky projekt në zhvillimin e artit dhe Kulturës në qytetin e Korçës, vlerësuam se mbështetja e tij do i vlejë Korçës në vecanti dhe Rajonit në tërësi.

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 14 dhe neni 77.Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimin nr.9 dt.20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin plotësues nr.1 dt.24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.25 dt.22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024, ju paraqesim për miratim Projekt Vendimin “Mbi miratimin e marrëveshjes të mbështetjes financiare për bashkinë korçë, në lidhje me projektin e ndërtimit të rezidencës artistike në korçë, si dhe ndryshimit nw buxhet.

Korçë, më 06.06.2024

P.Finance : Oljona Beqiraj